



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1037/Prot.  
2

Tiranë, më 10 /07/2018

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 10 / 7 /2018**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankesën nr. 1037 Prot., datë 20.06.2018, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Bashkisë Bulqizë, (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Me kërkesën e datës 01.06.2018, Z. ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni i mëposhtëm:

- *Lista e plotë e të punësuarve në bashkinë Bulqizë dhe institucionet nën varësi; emër mbiemër, arsimi përkatës, grada (Bachelor, Msc, Dr. etj), pozicioni i punës dhe një formë kontakti (email ose numër telefoni).*

Me shkresën nr. 1826/1, datë 12.06.2018, Autoriteti Publik ka refuzuar dhënien e informacionit me argumentin se informacioni i kërkuar klasifikohet konfidencial bazuar në pikën 5 të VKM-së nr. 117 datë 05.03.2014 "Për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit".

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me shkresën nr. 1037/1, datë 28.06.2018, kërkoj parashtrime nga Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit që mund të bëhet publik sipas objektit të kërkesës.

Pavarësisht komunikimeve të vazhdueshme me Autoritetin Publik, detyrimi për vënien në dispozicion të asaj pjese të informacionit të kërkuar që klasifikohet si publik nuk u përmbush edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga Zyra e Komisionerit (datës 02.07.2018).

Pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës Zyra e Komisionerit konstaton se, Autoriteti Publik ka refuzuar *a priori* dhënien e informacionit duke mos marrë në konsideratë faktin se një pjesë e tij është informacion publik i cili, në bazë të nenit 7, pika 1, shkronja d) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duhet të jetë pjesë e Programit të Transparencës dhe i duhet vënë në dispozicion publikut pa kërkesë.

Konkretisht dispozita e sipërcituar përcakton se: *"Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatisin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshëm, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet ... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime."*

Sa i përket të dhënave të kërkuara lidhur me punonjësit e tjerë të Bashkisë Bulqizë dhe institucioneve në varësi të saj, të cilët nuk i nënshtrohen detyrimit për deklarimin e pasurisë, Komisioneri vlerëson se, përveç të dhënave si emër, mbiemër dhe pozicion pune, aksesit në të dhënat e tjera personale, si në rastin konkret arsimit përkatës, grada dhe të dhënat e kontaktit të tyre, mund të jepen vetëm kundrejt pëlqimit, në cilësinë e subjektit të të dhënave personale (referuar nenit 6/1/a ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar), i cili duhet të jepet me vullnetin e lirë dhe të jetë në formë shkresore.

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t'i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e llogaridhënies si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interes të të dy palëve.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon:

*Neni 15 "1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre."*

*Neni 23 "E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."*

Në nenin 10 të KEDNJ është përcaktuar se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë".

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është pjesërisht e bazuar në ligj dhe për atë pjesë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës së Z. , Nr. 1037 Prot., datë 20.06.2018, ndaj Autoritetit Publik "Bashkisë Bulqizë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion, brenda datës 17 . 7 .2018, të informacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës, dhe konkretisht:
  - *Listën e plotë të të punësuarve në Bashkinë Bulqizë dhe institucionet nën varësi, së bashku me pozicionin e tyre të punës; Sa i përket funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, duhet vënë gjithashtu në dispozicion arsimi përkatës dhe grada (Bachelor, Msc, Dr. etj).*
3. Rrëzimin e ankesës përse i përket informacionit që kërkohet lidhur me të dhënat e kontaktit të punonjësve si dhe atij që ka të bëjë me arsimin dhe gradat e punonjësve që nuk i nënshtrohen detyrimit për deklarimin e pasurisë, sipas kërkesës për informacion datë 01.06.2018.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e informimit".
5. Ky vendim u shpall sot në datë 10 . 7 .2018.

KOMISIONERI

Besnik DERVISHI